



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.748/3 prot.

Tiranë, më 11. 12. 2023

V E N D I M

Nr. 244, datë 11. 12. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 122, datë 16.06.2023¹, të E. Gj., i përfaqësuar nga Shoqata Rinore Sportive Studenti (SHRSS) kundër Federatës Shqiptare Taekwondo-World (FSHT), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Shoqata ka qenë vazhdimisht subjekt i diskriminimit në vendimet e marra nga Komisionet e Federatës Shqiptare Taekwondo, në të cilën shoqata është tashmë anëtare me të drejta të plota.

Arsyeja e kësaj ankese vjen nga trajtimi që komisioni ekzekutiv i ka bërë kërkesës së shoqatës për pjesëmarrje në një aktivitet. Konkretisht, shoqata ka bërë kërkesë për pjesëmarrjen e sportistit elitare E. Gj. në kampionatin Botëror Baku 2023. Kjo kërkesë u bazua në rregulloren e brendshme të federatës (‘neni 41, pika 15 i rregullores së brendshme).

Neni 41- Ekipi Kombëtar

15.- Nuk mund të marrë pjesë në ekipin kombëtar një sportist që nuk ka marrë pjesë në Kampionatin Kombëtar. Në rastin kur pjesëtarët e ekipit kombëtar marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare me shpenzimet e tyre, një sportist që nuk ka marrë pjesë në Kampionatin Kombëtar mund të jetë pjesë e ekipit kombëtar kur ka kategori peshe të lirë vetëm pasi Komisioni Teknik të ketë vlerësuar gjendjen teknike të tij dhe Komiteti Ekzekutiv të jetë shprehur me vendim për propozimin e Komisionit Teknik.

E. Gj. do të konkuronte në kategorinë -54 kg, e cila ishte e lirë si kategori pasi kampioni në fuqi ishte tërhequr. Komisioni ekzekutiv vendosi të refuzonte kërkesën e cila u refuzua pa asnjë

¹ Ankesa është plotësuar nga ankuesi, me informacionin dhe dokumentacionin e dërguar me e-mail-in datë 06.07.2023.

² Si anëtar i Shoqatës Rinore Sportive Studenti të Klubit Studenti.

argument teknik, të cilin rregullorja e ka kusht, si dhe u arsyetua subjektivisht nga ana e anëtarëve të komisionit ekzekutiv. Komisionit teknik nuk ju kërkua një vlerësim nga komisioni ekzekutiv.

Vendimi i tyre nuk bazohet në rregulloren e brendshme të federatës, por ishte vendim subjektiv. E. Gj. është kampion Kombëtar, kampion Ballkani si dhe mban rekordin kombëtar të ndeshjeve të fituara në kampionatin Botëror.

Në përfundim, shoqata jonë vazhdimisht është diskriminuar nga sekretariati, komisionet ekzekutive, teknike dhe disiplinore të Federatës Shqiptare të Taekwondo. Ky diskriminim shkon kundër parimeve sportive të fairplay, kundër statutit dhe rregullores së brendshme të federatës ku ne aderojmë.

Gjendur në pamundësi për të patur komunikim të hapur dhe gjykim objektiv nga Federata Shqiptare e Taekwondo i drejtohem Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Mbështetur në e-mail-in datë 06.07.2023, SHRSS, sqaroi ndër të tjera se situata diskriminuese nga Federata Shqiptare Taekwondo-World, ndaj anëtarëve të saj ka nisur në momentin e emërimit në pozicionin e trajnerit J. C. dhe Shoqatës Rinore Sportive Studenti në Klubin Studenti. Kjo pasi: *“Organika e Federatës ka qenë kundër aderimit të trajnerit J. C. dhe Shoqatës Rinore Sportive Studenti në Klubin Studenti, pasi këtë pozicion e dëshironin për një anëtar tjetër të federatës (Xh. H.). Kjo dëshirë e tyre është tërësisht subjektive dhe ne si shoqatë kemi zbatuar rregulloren në çdo hap tonin. Dëmet e ardhura nga vendimet e Federatës Shqiptare të Taekwondo kanë qenë të shumta.*

Në vitin 2021 trajneri J. C. u punësua si trajner në Klubin Shumësportësh Studenti, bazuar në rregulloren e klubit në fjalë. Në datë 22.11.2021 është lidhur kontratë bashkëpunimi mes Klubit Shumësportësh Studenti dhe Shoqatës Rinore Sportive Studenti, bazuar në rregulloren e klubit. Këto kontrata mundësojnë që Shoqata Rinore Sportive të përfaqësojë Klubin Studenti në të gjitha aktivitetet sportive, ku anëtarët e shoqatës marrin pjesë. Federata përkatëse e disiplinës së Taekwondo nuk e ka përkrahur këtë bashkëpunim të ligjshëm dhe menjëherë është shprehur kundër (referuar e-mail-it datë 12.11.2021 të sekretarit të përgjithshëm të Federatës dhe deklaratës zyrtare në facebook të Federatës në datë 12.11.2021) dhe ka marrë vendime diskriminuese ndaj shoqatës dhe anëtarëve. Në Nëntor 2021 në adresën e-mail zyrtare të anëtarëve të Federatës Shqiptare Taekwondo, sekretari i federatës dërgon një e-mail ku pasqyron kërkesën e rianëtarësimit të klubit, si një kërkesë të “pa drejtë”, pasi organika e federatës nuk ishte dakord me trajnerin dhe shoqatën e aderuar tek Klubi Studenti. Sekretari shkruan në e-mail se ky pozicion ishte i dëshiruar nga një trajner tjetër, i përkrahur nga Federata Shqiptare Taekwondo dhe se nuk e përkrahnin trajnerin J. C. dhe Shoqatën Rinore Sportive Studenti. Nga momenti që shoqata filloi bashkëpunimin me klubin, është sulmuar vazhdimisht nga Federata Shqiptare e Taekwondo! Duke gjykuar subjektivisht të gjithë situatën, organika e federatës ka gjykuar në dëm të shoqatës dhe anëtarëve të saj, me shkakun e vetëm se nuk ishte dakord me këtë bashkëpunim...

Së fundmi kemi marrë njoftim nga sekretari federatës se sportistit të ekipit tonë E. Gj., i është mohuar shpërblimi si kampion ballkani.

Në ligjin e sportit dhe VKM përkatëse, sportistët të cilët fitojnë vendin e parë në kampionatin ballkanik kanë të drejtën e një shpërblimi nga ana e MAS...”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe mos përsëritjen në të ardhmen të ndalimit të pjesëmarrjes në aktivitetet kombëtare, ndërkombëtare dhe të hapura.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 748/1, datë 13.07.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Federata Shqiptare e Taekwondo Wold, për ankesën e bërë nga E. Gj. dhe kërkoj dokumentacionin si më poshtë:
 - Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Informacion dhe kopje të dokumentacionit mbi statusin e Shoqatës Rinore Sportive Studenti, si anëtare e Federatës Shqiptare të Taekwondo World.
- Fakte dhe prova lidhur me refuzimin e pjesëmarrjes së sportistit E. Gj. në Kampionatin Botëror Baku 2023. Të depozitohen në cilësi prove pranë KMD-së të gjitha aktet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja e Federatës Shqiptare të Taekwondo.
- Informacion dhe kopje të korrespondencës së mbajtur mes Federatës Shqiptare të Taekwondo World dhe Shoqatës Rinore Sportive Studenti, sa i përket refuzimit të kërkesës për pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror Baku 2023.
- Informacion nëse përgjatë viteve 2021-2023, janë refuzuar sportistë të tjerë nga Federata Shqiptare e Taekwondo World, për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet kombëtare, ndërkombëtare dhe të hapura. Të depozitohen në cilësi prove pranë KMD-së të gjitha aktet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja e Federatës Shqiptare të Taekwondo.
- Informacion nëse janë refuzuar sportistë të tjerë nga Federata Shqiptare e Taekwondo World, për pjesëmarrjen e tyre në Kampionatin Botëror Baku 2023. Të depozitohen në cilësi prove pranë KMD-së të gjitha aktet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja e Federatës Shqiptare të Taekwondo.
- Informacion nëse përgjatë viteve 2021-2023, i është mohuar sportistëve të tjerë nga Federata Shqiptare e Taekwondo World, shpërblimi si kampion ballkani apo aktivitete të tjera kombëtare apo ndërkombëtare. Të depozitohen në cilësi prove pranë KMD-së të gjitha aktet mbi të cilat është mbështetur vendimmarrja e Federatës Shqiptare të Taekwondo.
- Kopje të Statutit, Kodit të Etikës dhe Rregullores së Brendshme të FSHT-së.

Me shkresën nr. 202, datë 26.07.2023, Federata Shqiptare e Taekwondo Wold, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Lidhur me kontratën midis Shoqatës Rinore Sportive Studenti dhe Klubit Studenti, ne si Federatë nuk kemi pretendime. Vërejtja që i është dhënë ankuesit, ka të bëjë me faktin se Shoqata Rinore Sportive Studenti është regjistruar në kompeticionet kombëtare dhe ndërkombëtare si Klubi Studenti, kur sipas Statutit të Federatës në nenin 4, Anëtarësia dhe sipas Rregullores së Brendshme, Kreu III, neni 17 dhe Kreu V, në këto kompeticione marrin pjesë Shoqatat anëtare të Federatës tonë. Ndërsa Klubi Studenti nuk është anëtar i Federatës tonë. Fakti se midis Shoqatës dhe Klubit ka një marrëveshje, ajo duhet të zbatohet vetëm përse shkruhet aty midis dy palëve, por jo të veprohet në kundërshtim me Statutin e Federatës ku Shoqata Rinore Sportive Studenti është anëtare.*

Në lidhje me Vendimin e Komisionit të datës 25.05.2023, është bërë vetëm propozimi që Shoqata Rinore Sportive Studenti të kaloj në statusin provizor, por akoma nuk është marrë një vendim nga Federata Shqiptare e Taekwondo World në lidhje me këtë propozim. Ky propozim do të shqyrtohet në Asamblenë e Përgjithshme të radhës, e cila akoma nuk është vendosur se kur do mblidhet.

Në lidhje me trajnerin J. C. s'kemi patur dhe as nuk kemi problem me zgjedhjet e tij.

Në lidhje me ankesën për sportistin E. Gj., kjo ankesë nuk qëndron si ligjërishit e as moralisht. Kjo pasi sportistët zgjidhen mbi bazën e kriterëve përcaktuese në rregulloren e brendshme të Federatës.

Nga këto kritere, sportisti E. Gj. nuk i përmbushte kriteret e kategorisë, ndaj edhe nuk është përzgjedhur nga Komisioni.

Duke qenë se sportisti E. Gj. ka garuar si sportist i Shoqatës por jo sportist i Ekipit Kombëtar, atëherë shpërblimin duhet ta kërkoj në Ministrinë e Sportit nëpërmjet Shoqatës ku ai bën pjesë, por jo Federatës.

Në lidhje me pretendimet për trajnerin J. C., çdo Vendim u është komunikuar palëve me mail dhe çdo infomacion dhe përgjigje është dhënë në mail ku na kanë shkruar.

...Ankuesi për çdo pakënaqësi, duhej ti ishte drejtuar fillimisht Federatës, organeve të saj përgjegjëse për çdo sektor dhe pastaj Gjykatës, duke patur parasysh ligjin për OJF-t mbi bazën e të cilit Shoqatat marrin statusin juridik si edhe veprojnë e operojnë juridikisht dhe financiarisht”.

2. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 748/2, datë 10.10.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 25.10.2023, me praninë e përfaqësueses me Prokurë të Posaçme³ dhe Autorizimin e administruar në dosje, të Shoqatës Rinore Sportive Studenti: I. K, dhe në mungesë të përfaqësuesve të Federatës Shqiptare të Taekwondo.

Përfaqësuesit e palës ankuese, gjatë seancës parashtruan të njëjtat fakte e rrethana që kishin paraqitur edhe në formularin e ankesës dhe në vijimësi gjatë komunikimeve me e-mail me KMD-në.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, Shoqata Rinore Sportive Studenti, nëpërmjet e-mail-it të datës 01.12.2023, ka falenderuar Komisionerin për procedurën e zhvilluar për shqyrtimin e ankesës së saj, dhe ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa e regjistruar me nr. 122 Regj., datë 16.06.2023, pranë Zyrës së KMD-së, pasi Shoqata po e ndjek këtë çështje në Gjykatë.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e

³ Prokurë e Posaçme me nr. repertori 934, nr. koleksioni 258, datë 05.07.2023, lëshuar nga Noterja A. M.

parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94⁴/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, E. Gj., përfaqësuar nga Shoqata Rinore Sportive Studenti, e cila, me anë të kërkesës të përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 01.12.2023, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 01.12.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 122 regj., datë 16.06.2023, të paraqitur nga E. Gj., përfaqësuar tek Komisioneri nga Shoqata Rinore Sportive Studenti (SHRSS) kundër Federatës Shqiptare Taekwondo-World (FSHT), nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 122 Regj., datë 16.06.2023, të E. Gj., i përfaqësuar nga Shoqata Rinore Sportive Studenti, kundër Federatës Shqiptare Taekwondo-World, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

⁴ “Tërheqja e ankesës”.

Punoi: R. Babaj
Rishikoi: A. Xhindi
Pranoi: V. Bushati
Datë: 06.12.2023